

**V E N D I M**  
**Nr.601, datë 2.11.2001**

**PËR FUNKSIONET NË MINISTRINË E RENDIT PUBLIK, QË KANË TË DREJTËN E**  
**MBAJTJES SË GRADËS SË POLICISË SË SHETËTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në Ministrinë e Rendit Publik, jashtë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, kanë të drejtën e mbajtjes së gradës, sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, funksionet në përbërje të Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm dhe të Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

2. Punonjësit në funksionet e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi gëzojnë të gjitha të drejtat e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**